**DREJTUESI I PUNIMEVE** **BASHKIA GRAMSH**
**KRYETARI**

---

# KONTRATË

Nr.6618 Date 07/10/2016

PËR
DREJTIMIN E PUNIMEVE NE OBJEKTIN: "SISIEMIM ASFALTIM BLLOKU I BANIMIT NE LAGJEN SPORTI 2,BASHKIA GRAMSH"

Sot me date 07.10.2016 midis Bashkise Gramsh (INVESTITOR) e perfaqesuar nga Kryetari Znj.Luljeta Dollani dhe Drejtuesit te punimeve Ing.Sofie Topuzi me numer License MK 0068/2,te caktuar ne objektin:" Sistemim,asfaltim blloku i banimit ne lagjen Sporti 2,bashkia Gramsh" ,caktuar me Vendimin Nr.130,date 07/10/2016 te Kryetarit te bashkise ,me permbajtjen si me poshte :

**Baza ligjore.**

Bazuar ne ligjin nr.8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit"kapitulli I III-te
UKM nr.3 I ndryshuar me UKM nr.4 date 17.05.2001 "Per nje ndryshim ne UKM nr.3 date 15.02.2001 Per mbikeqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit".ndryshuar me UKM nr.7 dt 21.11.2001.
Dispozitat e Kodit te Procedurave Administrative ne lidhje me afatet , njoftimet,ankimet etje.
Dispozitat e Kodit Civil per sipermarrjen.
Dokumentacioni administruar ne dosjen e zhvillimit te tenderit per objektin: " Sistemim,asfaltim blloku i banimit ne lagjen Sporti 2,bashkia Gramsh"
*OBJEKTI I KONTRATES*

*NENI 1*

Objekti i kontrates eshte mbikqyrja e punimeve nga: Ing.Sofie Topuzi me numer License MK 0068/2..te caktuar ne objektin: " Sistemim,asfaltim blloku i banimit ne lagjen Sporti 2,bashkia Gramsh"
*II. DETYRIMET E DREJTUESIT(MBIKQYRESIT)TE PUNIMEVE*

*NENI 1*
Drejtuesi (Mbikqyresi) i punimeve mban pergjegjesi dhe pergjigjet per dokumentacionin tekniko-administrativ per realizimin e punimeve te sipermarrjes ne objekt si licensa,kontrata,ditar objekti,libreze masash,certifikata materialesh,plan-organizimin e punimeve.

ING. SOFIJE TOPUZI
MBIKQYRJE KOLAUDIM
PROJEKTIM

Drejtuesi (Mbikqyresi) i punimeve merr pjese ne kolaudimin e vepres e i pergjigjet kolaudatorit me te gjithe dokumentacionin e objektit dhe firmos procesverbalin e kolaudimit.

*NENI 11*

Situacionet e paraqitura nga sipermarresi ne fazat e ndryshme te punimeve kontrollohen dhe miratohen nga Drejtuesi (Mbikqyresi) i punimeve.Pagesa mund te kryhet vetem ne baze te ketij miratimi.Keto dokumenta dergohen ne drejtorine e menaxhimit ekonomik dhe financiar dhe ky i fundit i percjell per konfirmim tek Kryetari Entit Prokurues,bashke me vertetimin e perkohshem te pageses per te shpallur vleren e detyrueshme per pagim.

*NENI 12*

Mbas perfundimit te kolaudimit, Drejtuesi (Mbikqyresi) i punimeve mbeshtetur ne kontraten dhe ne dokumentacionin tjeter,percakton vleren perfundimtare te objektit e cila i behet e ditur sipermarresit,si dhe i jepet per likuidim investitorit.

.

III. DETYRIMET E INVESTITORIT

*NENI 1*

a)Ti jap dhe vere ne dispozicion te Drejtuesi (Mbikqyresi) te punimeve te gjithe dokumentacionin e zhvillimit te tenderit per

b)Te njoftoj Drejtuesin (Mbikqyresi) e punimeve diten kur do te dorezoj objektin per fillimin e punimeve.

c)Te njoftoj Drejtuesin (Mbikqyresin) e punimeve per diten kur grupi i ngritur enkas nga bashkia do te marre ne dorezim punimet

d) Te shperbleje Drejtuesin (Mbikqyresin) e punimeve per punen e kryer sipas procedurave te tenderit te "Blerje e Vogel"me 7111(shtate mije e njeqinde njembedhjete)leke pa Tvsh te zhvilluar me date 06.10.2016.

e)Per mangesi ne plotesimin detyrave,kur vertetohen mangesi serioze ne veprimtarine e tij,Bashkia Gramsh ka te drejte largimin dhe zevendesimin e mbikeqyresit te punimeve.

*III. TE NDRYSHME*

*NENI 1*

a)Kjo kontrate eshte ne funksion dhe do te behet aneks i kontrates se sipermarrjes ,qe do te lidhet midis Bashkimi i Operatoreve Ekonomike"Bajrami-N-&"Meteo"shpk,te perfaqesuar me prokure nga z.Geri Zogu ne cilesine e sipermarresit dhe bashkise Gramsh.

b)Komunikimi do te behet vetem me shkrim ai behet efektiv per bashkine vetem pasi ai te jete protokolluar ne Librin e Korespodences se ketij institucioni .

c)Zgjidhja e mosmarreveshje behet ne gjykate.

Kjo kontrate hartohet ne pese kopje te barabarta dhe pasi u gjend e bazuar ne ligj me vullnetin e lire te paleve firmoset si me poshte :

| | |
|---|---|
| **DREJTUESI I PUNIMEVE** | **KRYETARI** |
| **Ing. *Sofie TOPUZI*** | ***LULJETA DOLLANI*** |

ING. SOFIE TOPUZI
MBIKQYRJE KOLAUDIM
PROJEKTIM

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA GRAMSH